



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 24

Tiranë – E enjte, 6 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 5.2.2025	Për një shtesë në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar.....	3015
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 5.2.2025	Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar.....	3015
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 5.2.2025	Për lirimimin dhe emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Kukësit....	3016
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 78, datë 30.1.2025	Për një ndryshim në urdhrin nr. 166, datë 27.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre, si dhe formën e kartës së identifikimit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave”, të ndryshuar.....	3016

**AKT NORMATIV**
Nr. 1, datë 5.2.2025**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8668,
DATË 23.10.2000, “PËR PAJISJEN E
SHTETASVE SHQIPTARË ME
PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas nenit 14/3, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, shtohet neni 14/4, me këtë përmbajtje:

“Neni 14/4

Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 11 maj 2025, zgjatet deri në datën 31 maj 2025 për shtetasit me vendbanim jashtë vendit, votues në zgjedhjet për Kuvendin, të shpallura me dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit të Republikës.

Kjo zgjatje e afatit të vlefshmërisë së pasaportave ka efekt vetëm për ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur në datën 11 maj 2025.”.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 5.2.2025**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN
NR. 8952, DATË 10.10.2002,
“PËR LETËRNJOFTIMIN
ELEKTRONIK TË SHTETASVE
SHQIPTARË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas nenit 9/4, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, shtohet neni 9/5, me këtë përmbajtje:

“Neni 9/5

Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik, që përfundon deri në datën 11 maj 2025, zgjatet deri në datën 31 maj 2025 për shtetasit me vendbanim jashtë vendit, votues në zgjedhjet për Kuvendin, të shpallura me dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit Republikës.

Kjo zgjatje e afatit të vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik ka efekt vetëm për ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur në datën 11 maj 2025.”.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM**
Nr. 81, datë 5.2.2025**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË**
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË KUKËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Agron Geca, prefekt i qarkut të Kukësit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Dritan Baji emërohet prefekt i qarkut të Kukësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 78, datë 30.1.2025**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN**
NR. 166, DATË 27.4.2022, TË MINISTRIT
TË DREJTËSISË, “PËR FORMËN,
PËRMBAJTJEN DHE KARAKTERISTIKAT
E TJERA TË VULËS DHE RREGULLAT
PËR PAJISJEN DHE ADMINISTRIMIN E
TYRE, SI DHE FORMËN E KARTËS SË
IDENTIFIKIMIT TË PËRKTHYESIT
ZYRTAR DHE INTERPRETIT TË
GJUHËS SË SHENJAVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 166, datë 27.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre, si dhe formën e kartës së identifikimit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Shtojca nr. 1, bashkëlidhur urdhrin nr. 166, datë 27.4.2022, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, interpretët e gjuhës së shenjave, Drejtoria e Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË NR. 1
FORMA DHE PËRMBAJTJA E VULËS SË
PËRKTHYESIT ZYRTAR

Vula e përkthyesit zyrtar ka ngjyrë blu dhe formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj në pjesën e sipërme shkruhen me shkronja të mëdha në formë të harkuar fjalët “PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS”. Në mes të rreshtit, me shkronja të mëdha, shkruhet emri dhe mbiemri i përkthyesit zyrtar. Poshtë emrit shkruhet “certifikatë nr.” ku shënohet numri i certifikatës së përkthyesit zyrtar. Në pjesën e poshtme të rrethit në formë të harkuar të shkruhet me shkronja të mëdha në vend të fjalës “GJUHA”, gjuha për të cilën është certifikuar përkthyesi.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë

